

Në përputhje me Nenin 230 , parografi 2 i Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe Nenin 28, parografi 3 i Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” të ndryshuar, ky dokument përbën:

STATUTI

I

SHOQËRISË

“DEL-CNG” SH.P.K

TIRANË/SHQIPËRI

Tiranë, më 30.06.2023



A handwritten signature in blue ink, appearing to be in the name "Dritan".

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DEL-CNG” SH.P.K

KAPITULLI I
EMËRTIMI, FORMA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA, KOHËZGJATJA
NENI 1
EMËRTIMI DHE FORMA E SHOQËRISË

- 1.1 Sot, më datë 30.06.2023 (dymijë e njëzet e tre), në qytetin e Tiranës duke u bazuar në vullnetin e tyre të lirë, të plotë dhe të sinqertë në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritet Tregtare” (i ndryshuar) dhe Ligjet Nr. 9723, datë 03/05/2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” (i ndryshuar), Ortaku i Vetëm i shoqërisë:
- **Znj. Nataliya PRYKHODKO**, shtetase ukrainase, lindur më 04.11.1965, në Ukrainë, banuese në Ukrainë, mbajtëse e Pashaportës me Nr. Personal: FT584037, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Ortakut të Vetëm zotëruesh të 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Ka hartuar dhe nënshkruar këtë Statut në përshtatur me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritet Tregtare” i ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” (i ndryshuar), si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë pozitën juridike të veprimtarisë private.

NENI 2
BAZA LIGJORE

- 2.1. Shoqëria harton këtë Statut në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritet Tregtare” i ndryshuar dhe Ligjet Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë pozitën juridike të veprimtarisë private.

NENI 3
EMËRTIMI I SHOQËRISË



- 3.1. Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “**DEL-CNG**” SH.P.K, më poshtë referuar si “Shoqëria”.

**NENI 4
SELIA**

- 4.1. Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Elbasanit, Vila nr.71, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë, Shqipëri.
- 4.2 Shoqëria mund të hapë filiale, degë përfaqësie ose agjensi në varësi të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në çdo kohë që çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovin e organeve kompetente.

**NENI 5
OBJEKTI**

- 5.1. Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie përfshin por nuk kufizohet si më poshtë:
- Ndërtimi i një impianti të kompresimit të gazit, përfshirë por pa u kufizuar në ndërtimin e të gjithë infrastrukturës së kantierit, tubacionit nga fusha/kolektori i gazit deri në kantier, kompresor/turbozgjerues, depot e gazit, etj. Ndërtimi i një laboratori të certifikuar për testimin e mostrave të gazit.
- Çdo aktivitet tjetër të dobishëm ose të nevojshëm për arritjen e objektit të saj ose që ka lidhje me të në kuptimin më të gjerë të fjalës.
- 5.2. Për të realizuar objektin e veprimtarisë së saj, shoqëria mund të veprojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm, të lidhur, të dobishëm, të përafërt, elementar, etj në funksion dhe në nevojë të veprimtarisë së saj.
- 5.3. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshojë ose të shtohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

**NENI 6
KOHËZGJATJA**

- 6.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë në rastet e prishjes, falimentimit ose të likuidimit të shoqërisë, si dhe me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë, forma këto të parashikuara në legislacionin tregtar në fuqi.

KAPITULLI II



A handwritten signature in blue ink, appearing to be a name, is placed here.

KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT

NENI 7 KAPITALI THEMELTAR

- 7.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, tërësisht i nënshkruar dhe i pashlyer nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë:
- **Znj. Nataliya PRYKHODKO**, shtetase ukrainase, lindur më 04.11.1965, në Ukrainë, banuese në Ukrainë, mbajtëse e Pashaportës me Nr. Personal: FT584037, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e cili zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë.
- 7.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë.

NENI 8 TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR

- 8.1. Pjesët e kapitalit themeltar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen, nëpërmjet:
- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) Shitblerjes;
 - c) Trashëgimisë;
 - d) Dhurimit;
 - e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

8.1.1 Në rastin e kalimit të pjesëve të kapitalit themeltar me kontratë, kontrata duhet të hartohet në formë shkresore.

KAPITULLI III ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË DHE KOMPETENCAT E TYRE

NENI 9 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 9.1. Organet drejtuese të shoqërisë janë:
- 1) Asambleja e Përgjithshme,
 - 2) Administratori.



4

9.2. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues i shoqërisë. Në rastet kur shoqëria përbëhet nga një Ortak i Vetëm, të gjitha kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm.

9.3. Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka këto kompetenca:

- Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- Ndryshimet në Statut;
- Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Shitjen, transferimin dhe anullimin e kuotave të kapitalit themeltar;
- Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- Emërmin dhe shkarkimin e drejtueseve teknik;
- Emërimin dhe shkarkimin e Ekspertit kontabël dhe të likuidatorëve si dhe caktimin e shpërblimit të tyre;
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, duke përfshirë edhe përgatitjen e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- vendos për çdo çështje tjeter që i është rezervuar Asamblesë së Përgjithshme të parashikuar nga ligji për shoqëritë tregtare apo Statuti.

9.4. Të gjitha vendimet e Ortakut të Vetëm regjistrohen në regjistrin e vendimeve dhe shënimet përkatëse nuk mund të ndryshohen dhe/ose të fshihen. Në veçanti duhet të regjistrohen vendimet për:

- a) miratimin e bilanceve vjetore dhe të raporteve informuese për mbarëvajtjen e veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) vendimet që kanë të bëjnë me riorganizimin e shoqërisë dhe shkrirjen e saj.

NENI 10
THIRRJA DHE ZHVILLIMI I MBLEDHJEVE

10.1. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret në çdo kohë nga Administratori ose një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të pjesëve të kapitalit themeltar. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën 1(një) herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finansiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.



- 10.2. Mbledhjet zhvillohen në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të njoftuar nga Administratori.
- 10.3. Njoftimi kryhet me shkrim ose me postë elektronike jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

NENI 11 **MARRJA E VENDIMEVE**

- 11.1. Asambleja e Përgjithshme, në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kuotave.
- 11.2. Vendimet e Asamblesë, për të cilat kërcohët një shumicë e kualifikuar, sipas përcaktiveve ligjore dhe statutore, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të numrit total të votave.
- 11.3. Asambleja e Përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjes së fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.4. Nëse Asambleja nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të sipërcituar, Asambleja do të mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 11.5. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Prosesverbalit nënshkruhet nga kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit.

NENI 12 **PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE**

- 12.1. Çdo ortak mund të marrë pjesë personalisht në asamble ose mund të përfaqësohet me autorizim nga një ortak tjetër apo nga një i tretë i zgjedhur prej tij. Autorizimi është i vlefshëm vetëm për 1 (një) mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



A handwritten signature in blue ink, appearing to be a name, is placed here.

12.2. Administratori i Shoqërisë nuk mund të përfaqësojë ortakët në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve.

NENI 13 **ADMINISTRATORI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E TIJ**

13.1. Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

13.2. Shoqëria do të administrohet nga Z. Rafael Dushuzsky, atësia Boris, shtetas i Izraelit, lindur në USSR dhe banues në Shqipëri me adresë: Rruga "Sami Frashëri", Hyrja nr.7, Ap.12, Tiranë, Shqipëri, lindur më 22/10/1975, mbajtës i Pashaportës të Izraelit me nr. 23985797, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

13.3. Administratori ka të drejtë e detyrohet:

- Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- Të përfaqësojë shoqërinë tregtare në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose duke caktuar zëvendësues;
- Të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
- Të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë;
- Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit "Për Regjistrimin e Biznesit" *të ndryshuar*;
- Të raportojë para Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.
- Të kryejë çdo detyrë tjeter të përcaktuar në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" *të ndryshuar* dhe në Statut.

13.4. Administratori emërohet për një periudhë 1 (një) vjeçare duke filluar nga data 30.06.2023 deri më datë 30.06.2024, me të drejtë ripërtëritjeje.

KAPITULLI IV **VITI FINANCIAR, BILANCI DHE FITIMET**



NENI 14 VITI FINANCIAR

- 14.1. Viti finanziar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.
- 14.2. Si përjashtim, viti i parë i veprimtarisë së shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2023.
- 14.3. Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij, sigurimet shoqërore, etj. Ajo ka të drejtë të çelë llogari likuiduese pranë bankave dhe të kryejë veprime likuiduese me to, brenda dhe jashtë vendit.
- 14.4. Llogaritë vjetore, inventarët, raportet mbi operacionet e vitit finanziar miratohen nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.
- 14.5. Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin finanziar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit finanziar.

NENI 15 BILANCI. MBAJTJA E KONTABILITETIT

- 15.1. Bilanci vjetor i shoqërisë duhet të hartohet për t'iu paraqitur organeve tatimore deri në fund të muajit Mars të vitit pasardhës.
- 15.2. Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe në monedhën shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valutë të cilat do të konvertohen çdo muaj në monedhën shqiptare.
- 15.3. Pas shlyerjes së detyrimeve fiskale ndaj shtetit, fitimi neto mund të përdoret përzgjerimin e aktivitetit, përritjen e kapitalit të shoqërisë ose i shpërndahet ortakëve sipas kuotave të zotëruara.

NENI 16 FITIMET

- 16.1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, në raport me kuotat që ata zotërojnë.
- 16.2. Të ardhurat që do të rezultojnë deri në fund të mbylljes së çdo ushtrimori, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë, vetëm nëse:



8

- Aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KAPITULLI V **PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHEVE**

NENI 17 **PRISHJA E SHOQËRISË**

17.1. Shoqëria prishet:

- në përfundim të afatit të parashikuar nga Statuti;
- me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- me vendim të gjykatës.

17.2. Administratori do të regjistrojë vendimin për prishjen e shoqërisë, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përpunje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar. Në rast se prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim.

NENI 18 **LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

18.1. Në rast prishjeje shoqëria duhet të likuidohet.

18.2. Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Ortakëve emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raporte përfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

18.3. Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja vendos mbi bilancin finansiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesit dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

18.4. Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit Ortakëve të shoqërisë, në proporcion me kuotat e kapitalit të zotëruara prej tyre.

18.5. Likuidatori/ët njoftojnë Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e procesit të likuidimit duke këruar çregjistrimin e shoqërisë në përpunje me parashikimet e ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të ndryshuar.

NENI 19
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHEVE

- 19.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 19.2. Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje të mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, ato do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

KAPITULLI VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 20

- 20.1. Ky statut është hartuar në përputhje me:
 - i) Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (*i ndryshuar*);
 - ii) Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (*i ndryshuar*);
- 20.2. Për çështje që nuk janë shprehur plotësisht në këtë Statut, shoqëria i referohet Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", *i ndryshuar*.
- 20.3. Ky Statut, përbëhet nga 20 nene dhe u redaktua në 2 (dy) kopje identike në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha fuqi të njëjtë ligjore.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË
"DEL-CNG" SH.P.K.**

Znj. Nataliya PRYKHODKO



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Nataliya Prykhodko". Above the signature is a smaller, more stylized version of the same name.